



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË SUHAREKËS PËR VITIN 2022

Prishtinë, qershor 2023

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Suharekës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Suharekës (Komuna e Suharekës), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Suharekës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Suharekës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

**Baza për konkluzion**

- B1 Mungesa e projektit ekzekutiv.
- B2 Mos raportimi me kohë mbi koston e subvencioneve në shumë prej 25,000€.
- B3 Vonesa në ekzekutimin e pagesave të faturave.
- A1 Pagesa të projekteve nga buxheti i projekteve tjera.
- A2 Mos realizimi i projekteve kapitale sipas planit dinamik.
- A3 Pagesat përmes vendimeve gjyqësore/përmbartimore në shumë prej 972,282€.
- A4 Në tetë raste të pagesave në shumë totale prej 283,087€, është pranuar fatura para urdhërbljes dhe zotimit të mjeteve.
- A5 Mungesa e dëshmimeve për realizimin e punëve shtesë në vlerë 11,488€.
- C1 Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë.
- A6 Tejkalim i kontratës publike kornizë në shumë prej 25,152€.
- C2 Mos regjistrimi i plote i pasurive jo kapitale në shumë totale prej 27,729€ dhe mos raportimi i komisionit për inventarizim.
- A7 Mos nënshkrimi i planit të menaxhimit të kontratës nga palët kontraktuese.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Suharekës.

## Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Suharekës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Suharekës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Suharekës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Suharekës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Pagesat përmes vendimeve gjyqësore, procesi i i rekrutimit, pozitive me ushtrues detyre, procedurat e prokurimit publik dhe menaxhimit të kontratave, procesi i subvencionimit, shfrytëzimi i pronave publike pa kompensim dhe pa kontrata, proceset në menaxhimin e tatimit në pronë, menaxhimi i pasurisë dhe llogarive të arkëtueshme.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 17 rekomandime, prej tyre 12 janë rekomandime të reja, 3 të përsëritura dhe 2 pjesërisht të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja B1 - Mungesa e projektit ekzekutiv

**Gjetja** Neni 20 pika 10 i Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (UOPP) kërkon që specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutiv si pjesë substanciale të veten”.

Me rastin e testimit kemi gjetur se për katër projekte kapitale nuk është përgatitur projekti ekzekutiv por, komuna kishte iniciuar procedurat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe parallogaritë. Rastet e tilla ishin si në vijim:

- Projekti " Ndërtimi i kanalizimeve " në vlerë 261,327€;
- Projekti “Ndërtimi i rrugëve lokale në Mushtisht” në vlerë 72,213€;
- Projekti” Objekti sportiv” në vlerë 69,789€; dhe
- Projekti “Rregullimi i lumenjve” në vlerë 46,990€.

Shkaqet e mos hartimit të projektit ekzekutiv ishin sipas komunës që procedurat e prokurimit të mos vonohen. Megjithatë, kjo ishte si pasojë e mungesës së kontrolleve me rastin e procesit të prokurimit.

**Ndikimi** Zhvillimi i procedurave të prokurimit pa projekt ekzekutiv, mund të ndikoj që punimet e zbatuara në këtë projekt të devijojnë nga kërkesat standarde të ndërtimit dhe të mos arrijnë cilësinë e duhur.

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë që, hartimi i projekteve ekzekutive të realizohet në pajtim me kërkesat ligjore, gjegjësisht hartimin e tyre para inicimit të procedurave të prokurimit.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja B2 - Mos raportimi me kohë mbi koston e subvencioneve të dhëna

**Gjetja** Në bazë të Rregullores MF nr. 04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat për financimin publik të OJQ-ve, neni 23. Monitorimi dhe raportimi për projektet dhe programet në të cilat përfituesi i grantit raporton te zyrtari monitorues, në baza të rregullta në lidhje me zbatimin/programin i projektit siç parashikohet në kontratën e parashikuar në nenin 22 të kësaj rregulloreje. Raportimi përfshin raportimin narrativ dhe financiar dhe periudhat e raportimit do të përcaktohen në përputhje me dispozitat e kontratës me përfituesin.

Me rastin e rishikimit të subvencioneve kemi identifikuar se një OJQ me datën 09.08.2022, ka përfituar shumë prej 25,000€ por, nuk ka dorëzuar me kohë raporte përkatëse financiare dhe narrative për shpenzimet e bëra, siç është përcaktuar me kushtet e marrëveshjes.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme në monitorimin e subvencioneve.



- Ndikimi** Mungesa e raportimit të përfituesve të subvencioneve për shpenzimet e bëra sipas kërkesave përkatëse mund të rezultojë në keq menaxhim të buxheteve, mos justifikim të fondeve publike dhe dështim në arritjen e objektivave komunale.
- Rekomandimi B2** Kryetari duhet të siguroj se të gjithë përfituesit raportojnë në mënyrë të rregullt lidhur me implementimin/realizimin e projekteve, dhe për të gjithë ata që nuk raportojnë me kohë të marrë vendim që mos të jenë përfitues të subvencioneve në thirrjet publike të viteve pasuese.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B3 - Vonesa në ekzekutimin e pagesave të faturave**

- Gjetja** Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për MFPP çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore duhet të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Nga mostrat e testuara për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve kemi identifikuar tre mostra në vlerë totale prej 30,911€, të cilat nuk ishin paguar sipas afatit kohor ligjor prej 30 ditësh. Vonesat për këto fatura ishin prej 64 ditë deri në 73 ditë.

Faturat e paguara me vonesë ishin për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme.

- Ndikimi** Faturat e paguara me vonesë rrezikojnë që të shkaktohen shpenzime shtesë për shkak të mundësisë së aplikimit të ndëshkimeve.

- Rekomandimi B3** Kryetari duhet të sigurojë që, obligimet të planifikohen/ buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i Komunës me kosto shtesë.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A1 - Pagesa të projekteve nga buxheti i projekteve tjera**

- Gjetja** Sipas nenit 16 pikës 1 të Ligjit Nr. 08/I-066 Ndarjet buxhetore për vitin 2022, ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese apo zëvendësimin e projekteve kapitale të komunave, të prezantuara në tabelën 4.2, duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal. Rialokimet duhet të kryhen në përputhje me procedurat dhe kriteret e parapara me udhëzimin administrativ MF. Nr. 05/2019 për procedurat e transferit dhe rialokimit të ndarjeve buxhetore.

Më datën 28.12.2022 nga kategoria e investimeve kapitale ishte kryer pagesa në vlerë 15,001€ për projektin "Asfaltimi i rrugës magjistralja Suharekë-Prizren" duke përdorur fonde nga projektet për qëllime tjera dhe jo për të cilin ishte planifikuar. Për më tepër nuk ishte marrë vendimi nga Kuvendi Komunal për ri-destinim të mjeteve dhe ri-alokimini e ndarjeve buxhetor nga një projekt në një tjetër.

Zyrtarët nuk kanë ofruar ndonjë shpjegim për mos zbatim të kërkesës ligjore.

- Ndikimi** Shfrytëzimi i fondeve për qëllime tjera nga ajo për të cilin ishin buxhetuar pa një aprovim paraprak nga Kuvendi Komunal dhe ministri i financave, përveç që është në kundërshtim me ligjin e buxhetit, ndikon që të devijohen projektet nga ato të aprovuara në kuvendin komunal, në të cilin janë diskutuar dhe aprovuar prioritetet e qytetarëve.
- Rekomandimi A1** Kryetari duhet të siguroj se janë marrë veprimet e nevojshme që projektet e aprovuara të realizohen sipas planifikimit. Nëse paraqitet nevoja për ridedestinim të fondeve të projekteve, kjo të realizohet përmes procedurave të përcaktuara me rialokim në pajtim me Ligjin mbi ndarjet buxhetore.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja A2 - Vonesa në realizimin e projekteve

- Gjetja** Sipas nenit 81 të Ligjit për Prokurim Publik si dhe Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për prokurimin publik pika 61.6, 61.19 dhe 61.20, menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Secila kontratë publike ka të përcaktuar afatin kohor të implementimit.

Në gjashtë raste komuna nuk kishte realizuar punimet sipas planit dinamik:

- Projekti “Ndërtimi i rrugëve lokale në Samadrexhe” në vlerë 178,434€ e datës 10.06.2022 është paraparë me plan dinamik 90 ditë, ndërsa deri në fund të vitit ishte realizuar vetëm 50% e projektit;
- Projekti “Ndërtimi i rrugëve lokale në Budakovë” në vlerë 113,957€ e datës 17.05.2022 me plan dinamik 90 ditë, por deri në fund të vitit ishte realizuar vetëm 57% e projektit;
- Projekti “Ndërtimi i sallës sportive në SHMT” Skënder Laurasi” në vlerë 260,172€ e datës 10.05.2022 duhej të përfundonte për 120 ditë, por deri në fund të vitit 2022 ishte realizuar rreth 149,000€ apo vetëm 57% e projektit;
- Projekti “Ndërtimi i rrugëve lokale në Stavoqin” në vlerë 26,819€ i datës 14.07.2022 ishte realizuar vetëm 64%. Projekti ishte kontraktuar për tu finalizuar për 90 ditë;
- Projekti “Ndërtimi i kanalizimeve në komunën e Suharekës” ishte lidhur kontratë në vlerë 261,327€ me datë 04.07.2022, sipas planit dinamik ishte paraparë të realizohet për 120 ditë, por deri në fund të vitit 2022 ishte realizuar vetëm 65% e projektit; dhe
- Projekti “Ndërtimi dhe sanimi i kanalizimeve” në komunën e Suharekës ishte lidhur kontratë në shumë prej 247,063€ me datën 06.07.2022 me plan dinamik 120 ditë deri sa ishte realizuar projekti vetëm 69%.

Vonesat në realizimin e projekteve si rezultat i kushteve atmosferike si dhe mungesa e mjeteve buxhetore ishin si shkak i mos realizimit të projekteve sipas afateve të përcaktuara në kontrata.

- Ndikimi** Mos realizimi i projekteve sipas kushteve të kontratës ndikojnë që komuna

të mos arrijë objektivat e përcaktuara si dhe mund të shkaktojë vështirësi buxhetore për vitet pasuese.

**Rekomandimi A2** Kryetari duhet të sigurojë që projektet të mos iniciohen pa projekt konkret dhe pa buxhet dhe të forcohen kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve, në mënyrë që ato të përfundohen me kohë sipas planit dinamik.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A3 - Pagesat përmes vendimeve gjyqësore / përmbarimore**

**Gjetja** Neni 39 i LMFP, përcakton që Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) i OB është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për OB-në të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim. Ndërsa sipas nenit 40 të LMFP, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrimit të prerë nga gjykata/përmbaruesi.

Komuna e Suharekës gjatë vitit 2022 kishte paguar shumën 972,282€ si pasojë e vendimeve gjyqësore/përmbarimore duke përfshirë borxhin, interesat dhe shpenzimet përmbarimore në vlerë 176,324€ Pagesat sipas vendimeve gjyqësore ishin 910,345€, për paga e mëditje, 30,909€ për mallra e shërbime dhe 31,028€ për investime kapitale.

Kjo ka ndodhur për shkak të paqartësisë ligjore për pagesën e pagave shtesë/jubilare sipas marrëveshjes së MASHT-it me sindikatën e SBASHK-ut, që duhet zbatuar komunat në ekzekutim të pagesave dhe menaxhim të kontratave publike dhe vonesave në kompletim të lëndëve.

**Ndikimi** Pagesat përfshirë shpenzimet tjera përcjellëse të përmbarimit dhe interesit, ka shkaktuar kosto shtesë duke e dëmtuar buxhetin e komunës.

**Rekomandimi A3** Kryetari duhet të sigurojë se janë analizuar shkaqet që kanë rezultuar me mos pagesë me kohë të obligimeve të cilat kanë rezultuar me ngritjen e padive dhe procedura gjyqësore/përmbarimore ndaj komunës. Para hyrjes në obligime të sigurohen fondet e nevojshme, si dhe të forcohen kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve dhe në pagesën me kohë të obligimeve.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A4 - Zotimi i mjeteve jo sipas rregullave financiare**

**Gjetja** Rregulla financiare Nr.01/2013 neni 12 përcakton që fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, më pas zotimi i mjeteve, të procedohet urdhërblerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa.

Në 8 raste me vlerë totale 283,087€, fillimisht ishte pranuar fatura, pastaj ishte bërë zotimi i mjeteve dhe urdhërblerja.

Shkaku i një dukurie të tillë është planifikimi jo adekuat i buxhetit dhe iniciimi i procedurave duke shpërfillur zbatimin e rregullave në fuqi.

**Ndikimi** Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme dhe duke mos ndjekur procesin e shpenzimeve, krijojnë vështirësi të menaxhimit financiar apo të vie edhe tek mos kryerja e obligimeve nga të cilat mund të kenë kosto shtesë.

**Rekomandimi A4** Kryetari duhet të siguroj se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet puna/shërbimi dhe të kryhet pagesa.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A5 - Mungesa e dëshmive për realizimin e punëve shtesë**

**Gjetja** Me rregulloren nr. 33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera, neni 11, përcakton që nëpunësit civilë kanë të drejtë të kompensohen ose të marrin kohë të lirë për punën jashtë orarit, nëse mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë paraprakisht ka autorizuar dhe vërtetuar punën jashtë orarit.

Nga një listë mujore prej 83 punonjësve që kanë punuar jashtë orarit të punës gjatë ditëve të vikendit të muajit tetor-nëntor 2022, në vlerë totale 11,488.41€, përveç një raporti përmbledhës për pagesë mujore, nuk kishte evidencë analitike që dëshmon se në cilat ditë apo data dhe nga sa orë është punuar jashtë orarit apo gjatë vikendeve.

Shkak i kësaj është mungesa e kontrolleve të brendshme në autorizimin dhe mbikëqyrjen e orëve shtesë.

**Ndikimi** Mungesa e dëshmive për kryerjen e punëve shtesë, nuk siguron dhe nuk arsyeton nevojën e punëve dhe pagesave shtesë.

**Rekomandimi A5** Kryetari duhet të sigurojë se punët shtesë realizohen vetëm nëse paraprakisht janë arsyetuar orët e punëve shtesë nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, dhe se mbahet evidencë për orët dhe ditët e angazhimeve në punët shtesë.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja C1 - Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimit në pronë**

**Gjetja** Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 11.1 përcakton se, personi fizik i cili vendos se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor (për të cilën e deklaroi në Komunë), i lejohet zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit. Përveç kësaj, Ministria e Financave përkatësisht Departamenti i Tatimit në Pronë, ka njoftuar komunat për vendimin e marrë për regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, me qëllim të shmangies së dyfishimeve/ apo parregullsive dhe sigurimin e zbatimit efektiv të këtij neni.

Pas analizës së bërë, në lidhje me zbatimin e zbritjes së lejuar për vendbanimin parësor dhe zbatimin të Vendimit për regjistrimin e numrit personal, janë identifikuar mangësitë si në vijim:

Për 2,074 tatimpagues, është zbatuar zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit, duke u mbështetur në nenin 11 - "Zbritjet për vendbanim parësor", mirëpo kjo zbritje është bërë për pronat e personave për të cilët nuk ishte evidentuar numri personal.

Sipas konfirmimeve zyrtare, kjo çështje ishte bartur nga vitet paraprake dhe se departamenti i tatimit në pronë ka bërë rregullimin e mangësive të identifikuar në raportin e auditimit të vitit paraprak por këto korrigjime reflektohen në të dhënat e vitit 2023.

**Ndikimi** Zbatimi i zbritjeve të lejuara për tatimpaguesit pa numër personal dhe pa u deklaruar se vendbanimi i tatimpaguesit shërben si vendbanim parësor, rezulton me përlllogaritje të pasakta të zbritjeve për tatimin në pronë dhe rrjedhimisht më pak të hyra.

**Rekomandimi C1** Kryetari të sigurojë bashkëpunim dhe komunikim më të mirë ndërmjet Departamentit të Tatimit në Pronë Komunal dhe Ministrisë së Financave, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në të dhënat për tatimin e vlerësuar, apo ndonjë gabim tjetër eventual.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja A6 - Tejkallim i kontratës publike kornizë**

**Gjetja** Neni 56.15 Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik parasheh "Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit" artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), si p.sh. mirëmbajtje të veturave, mirëmbajtje të gjeneratorëve etj. Në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi".

Komuna e Suharekës me datë 13.10.2021 kishte lidhur kontratë publike kornizë me çmim për njësi për "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale" në

vlerë të parashikuar prej 108,913€. Për realizimin e kontratës, komuna kishte bërë tejkallim për 25,152€.

Kjo ka ndodhur për shkak se menaxheri i kontratës nuk ka pas njohuri që për kontratat publike kornizë të lidhura me çmim për njësi nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%).

**Ndikimi** Tejkallimi i kontratave publike kornizë ndikon në rritjen e shpenzimeve shtesë të paarsyeshme dhe të paplanifikuara të parasë publike si dhe mund të ndikon në rritjen e obligimeve komunale.

**Rekomandimi A6** Kryetari duhet të shtoj kontrollet për të siguruar që përmes menaxherit të kontratës do të bëhet mbikëqyrje e mirëfilltë e kontratave publike kornizë me çmim për njësi në mënyrë që të mos bëhet tejkallimi i tyre.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja C2 - Mos regjistrimi i plote i pasurive jo kapitale dhe mos raportimi i komisionit për inventarizim

**Gjetja** Neni 6 paragrafi 3 i Rregullores nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare përcakton që: “Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria.” Më tutje neni 19, pika 4.7, përcakton se inventarizimi i pasurisë duhet të kryhet para përfundimit të PFV-ve. Po ashtu, sipas nenit 20 “Organizata buxhetore duhet të bëjë vlerësimin e pasurisë jo financiar për të vërtetuar nevojshmërinë e pasurisë jo financiare për organizatën, gjendjen fizike dhe mundësinë për ta përdorur në njësitë tjera të organizatës”.

Në bazë të rishikimit kemi gjetur së blerjet e vitit të pasurive jo kapitale përkatësisht gjashtë pagesa në shumë totale prej 27,729€ nuk janë regjistruar në e-pasuria. Sa i përket pasurive kapitale, në krahasim me vitin paraprak, Komuna ka bërë progres të dukshëm në regjistrimin e tyre.

Komisioni i inventarizimit të pasurisë ishte formuar me kohë, mirëpo nuk kishte arritur të përfundoj raportin para përgatitjes së PFV dhe as deri në kohën e auditimit tonë deri më 20.04.2023.

Shkaku i mos regjistrimit të plotë të pasurive jo kapitale në e-pasuria, ka ndodhur ngase zyrtarja e pasurisë nuk ishte çertifikuar deri në fund të vitit. Ndërsa deri te mos përgatitja e raportit përmbledhës për inventarizim të pasurisë, ka ndodhur për shkak të moszbatimit të detyrave të përcaktuara me kohë nga zyrtarët përgjegjës.

**Ndikimi** Mos kryerja e procesit të inventarizimit brenda afatit të paraparë ligjore, si dhe mos regjistrimi i plotë i sistemit e-pasuria rrit rrezikun për informata të mangëta mbi gjendjen e pasurisë si dhe ndikon në prezantim jo të plotë të gjendjes së tyre në PFV.

**Rekomandimi C2** Kryetari duhet të siguroj që përmes sistemit e-pasuria evidentohen të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme me vlera nën 1,000€. Po ashtu, duhet të siguroj se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë kryhet me kohë dhe këto raporte të harmonizohen me gjendjen e pasurisë në regjistra dhe ti paraprijnë përgatitjes së PFV, në mënyrë që vlera e pasurisë të

prezantohet saktë.

## Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja A7 - Mos nënshkrimi i planit të menaxhimit të kontratës nga palët kontraktuese

**Gjetja** Sipas nenit 81 të LPP, autoritetet kontraktuese janë të obliguara të përgatisin planin për menaxhim të kontratës. Plani i Menaxhimit të Kontratës (më tutje PMK) është dokument i cili do të përditësohet bazuar në mbikëqyrjen e punëve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtruara në kontratën origjinale. PMK duhet të përdoret së bashku me rregullat e miratuara për menaxhimin e aktiviteteve të kontratës, të nxjerra nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

Plani i menaxhimit të kontratave nuk ishte nënshkruar nga palët kontraktuese për projektet si në vijim:

- "Vitalizmi i infrastrukturës për funksionin e projektit shtretërit shtëpiak" për vlerën e kontratës 832,610€;
- "Mirëmbajtja e dimërore e rrugëve lokale" për vlerën e kontratës 108,912€;
- "Furnizimi me pajisje të teknologjisë informative" për vlerën e kontratës 95,124€ dhe,
- "Furnizim me dru dhe pelet" për vlerën e kontratës 357,450€.

Kjo kishte ndodhur për shkak se menaxheri i kontratës nuk e kishte vlerësuar të nevojshme nënshkrimin pasi ato plotësohen sipas tyre në sistem.

**Ndikimi** Mos plotësimi me informatat, përkatësisht mos nënshkrimi i këtij dokumenti nga menaxheri i kontratës dhe pala kontraktuese, sipas kërkesave të LPP mund të rezultojë në mos përmbushjen e kontratës sipas kushteve të përcaktuara me kontratë.

**Rekomandimi A7** Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët projekteve të kontribuojnë që plani i menaxhimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga palët kontraktuese me qëllim të përmbushjes së detyrimeve kontraktuale.

## Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.2.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2022 ishte 2,537,946€, prej tyre ishin shpenzuar 2,470,247€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shërbime kontraktuese tjera, shpenzime për mirëmbajtje, furnizime me derivate, shpenzime të ndryshme shëndetësore, blerje e pajisjeve të IT-së etj.

#### Çështja A8 - Lidhja e kontratës pa përmbushur kriteret e dosjes së tenderit.

**Gjetja** Sipas neni 56.4 të LLP, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Më datën 05.01.2023 ishte bërë ri tenderimi për projektin "Transporti i nxënësve" në shtatë (7) lote. Fituesit e këtij projekti, nuk i kishin plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara me dosje të tenderit përkatësisht njoftimit për kontratë, pasi që asnjëri nga fituesit nuk kishin ofruar çertifikatën për regjistrim në TVSH të lëshuar nga ATK. Ky kriter ishte përcaktuar në njoftimin për kontratë pika III.2.2 përshtatshmëria profesionale. Pavarësisht kësaj, fituesit ishin shpallur pa e plotësuar këtë kriter.

**Ndikimi** Lidhja e kontratës pa i përmbushur të gjitha kriteret, eliminon mundësinë e një procesi të mirëfilltë të prokurimit, e cila mund të përjashtoj nga procesi OE të përgjegjshëm dhe mund të ndikoj që kontrata të mos realizohet në mënyrë cilësore sipas kërkesave të tenderit.

**Rekomandimi A8** Kryetari duhet të sigurojë kontrollin e duhur përmes zyrës së prokurimit, në mënyrë që komisionet e vlerësimit të tenderëve bëjnë vlerësim dhe krahasim të drejt të ofertave. Po ashtu, të rishikoj procesin dhe të siguroj se janë përzgjedhur fituesit e përgjegjshëm duke pasur parasysh të gjitha kërkesat ligjore.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja A9 - Realizimi i aktiviteteve jashtë planit të prokurimit dhe mos njoftim i AQP-së

**Gjetja** Bazuar në Nenin 8 të Ligjit për Prokurimin Publik (me ndryshime dhe plotësime) AK duhet të bëjë planin e prokurimit, në të cilin identifikohen me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët, që AK parasheh ti prokurojë gjatë vitit fiskal në fjalë. Ndërsa sipas nenit 9, pika 6, e ligjit të njëjtë precizohet që nëse aktiviteti i prokurimit nuk është përfshirë në planifikimin final të prokurimit, duhet të njoftohet Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) të paktën 5 ditë para autorizimit të inicimit të aktivitetit të prokurimit.

Nga pesë mostra të testuara për testet pajtueshmërisë për procedura, në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, dy prej këtyre aktiviteteve të



zhvilluara nuk ishin përfshirë në planin final të prokurimit. Projektet e tilla ishin : Furnizim me dru dhe pelet për shkolla dhe furnizim me filma të RTG. Për më tepër nuk ishte njoftuar AQP-ja siç kërkohet me LPP-në.

Mos përfshirja e të gjitha kërkesave/nevojave të njërive, në planin e prokurimit ka ndodhur për shkak të mungesës së komunikimit dhe bashkëpunimit me njësitë tjera të cilat bëjnë kërkesat për prokurim.

**Ndikimi**

Planifikimi jo i plotë i aktiviteteve prokurimit, dhe realizimi i prokurimeve jashtë planit e vështirësojnë realizimin e planit të prokurimit dhe monitorimin e performancës si dhe krijon vështirësi financiare për komunën.

**Rekomandimi A9**

Kryetari duhet të sigurojë se do të merr masat e nevojshme që planifikimi i aktiviteteve të prokurimit do të përfshijë kërkesat nga të gjitha njësitë në mënyrë që sa më pak aktivitete të realizohen jashtë planit të prokurimit. Nëse ndodh ndonjë aktivitet jashtë planit, paraprakisht duhet të njoftohet AQP sipas kërkesave ligjore.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2.2 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 678,129€, prej tyre ishin shpenzuar 676,958€ apo mbi 99% të buxhetit. Ato kanë të bëjnë kryesisht me financime për entitete publike dhe jo publike, si dhe përfituesve individualë.

### Çështja A10 - Mos plotësimi i formularit për vlerësimin e aplikacioneve sipas poenëve

#### Gjetja

Në bazë të Rregullores MF nr. 04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat për financimin publik të OJQ-ve, neni 18 vlerësimi i aplikacioneve në aspektin përmbajtësor pika 3 përcakton që komisioni vlerësues do të ketë njëqind (100) pikë për vlerësim të projekteve/programeve të propozuara. Po ashtu, pika 4. Aplikantët të cilët marrin më pak se pesëdhjetë (50) pikë nuk mund të përfitojë mbështetje financiare në asnjë rast.

Në pesë raste që ishin përfitues të subvencioneve sipas thirrjes publike për OJQ, kemi vërejtur se komisioni i vlerësimit përveç që nuk ka ofruar dëshmi të shkruara në lidhje me vlerësimin aplikacioneve, nuk ka mbajtur as procesverbale për ta kuptuar se si ka ardhur deri tek përzgjedhja e përfituesve të subvencioneve nga Komuna. Përveç, kësaj shpallja publike për OJQ nga drejtoria për rini, kulturë dhe sporte, ishte bërë më datën 12.05.2022 deri më 25.05.2022, për 13 ditë kalendarike apo dy ditë më pak se rregullat e lejueshme.

Komisioni i vlerësimit pohon se nuk kanë qenë në dijeni se është dashur të përgatitet formulari i vlerësimit dhe të mbahen procesverbale. Po ashtu deri të shpallja e thirrjes publike jo sipas rregullave është bërë nga mos llogaritja e duhur e ditëve kalendarike.

#### Ndikimi

Çështja më lartë, ndikon në paqartësi tek aplikuesit në lidhje me tërë procesin dhe mos transparencën e ndarjes së subvencioneve dhe transfereve. Po ashtu, shpallja e thirrjes jo sipas afateve ligjore ndikon në mundësin dhe mos pjesëmarrjen e të gjithëve aplikuesve për projektet e caktuara.

#### Rekomandimi A10

Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se anëtarët që janë pjesë e komisioneve të vlerësimit, të respektojnë të gjitha kriteret e përcaktuara me Rregullore përkatëse. Po ashtu të sigurojë se shpallja publike bëhet komfor me rregullat ligjore me qëllim të dhënies së mundësisë për të gjithë OJQ-të, duke siguruar barazi në aplikim dhe vlerësim të drejtë dhe transparencë për fondet publike.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.2.3 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike si psh: mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

#### Çështja A11 - Mangësi për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale

##### Gjetja

Ligji nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës neni 22.2 Kryetari i Komunës obligohet që në raportet e tij të rregullta gjashtë (6) mujore ti paraqet Kuvendit të Komunës edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, deri në fillimin e implementimit dhe arritjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim. Ndërsa, neni 3 i marrëveshjes për qiradhënie përcakton se palët kontraktuese çdo vit të lidhin kontratë njëvjeçare me mundësi vazhdimi për çdo vit pasueses deri në përfundimin e marrëdhënies kontraktuale sipas nenit 1 të marrëveshjes. Sipas nenit 23 pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës.

Komuna e Suharekës kishte përgatitur raporte të rregullta gjashtë (6) mujore, mirëpo këto raporte nuk përmbanin informata lidhur me monitorimin dhe raportimin e realizimit të kontratave që kanë të bëjnë me dhënien në shfrytëzimin e pronave komunale. Për më tepër, dy marrëveshje të lidhura për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të pronave/lokaleve të komunës nuk ishin ripërtërirë që nga viti 2016. Po ashtu komuna nuk kishte zhvilluar procedura të cilat kërkohen sipas rregullores për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale por kishte lejuar operatorin ekonomik të shfrytëzoj pronën pa marrëveshje kontraktuale nga data 28.06.2022 deri në fund të vitit.

Bazuar në konfirmimet zyrtare shfrytëzimi i pronës pa marrëveshje kontraktuale dhe mos realizimi i procedurave, ishte si pasojë që prona e dhënë në shfrytëzim ishte në lënë hipotekë nga operatori ekonomik.

##### Ndikimi

Mungesa e monitorimit të realizimit të kontratave për pronat komunale të dhëna në shfrytëzim përveç se krijon pa pajtueshmëri ligjore rrezikon që këto prona të shfrytëzohen përtej periudhës së caktuar në kontratë si dhe mos përmbushje të qëllimit të dhënies së tyre.

##### Rekomandimi A11

Kryetari të siguroj që raportet rregullta gjashtë (6) mujore të përmbajnë edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme. Po ashtu, të siguroj që të bëhet ripërtërija e kontratave të parapara në marrëveshjet për qiradhënie.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2.4 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2022 ka shpalosur llogari të arketueshme në vlerë prej 6,772,436€. Kjo vlerë përbehet nga tatimi në pronë dhe në tokë, taksa komunale, shfrytëzimi i pronës publike dhe qiraja nga objektet publike.

### Çështja A12 - Mbivlerësimi i Llogarive të arkëtueshme

<b>Gjetja</b>	<p>Ligji nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 10.1.7, përcakton se, tatimi në pronën e paluajtshme nuk do të vendoset në pronën e paluajtshme e cila është në pronësi ose posedim të institucioneve fetare, prona e të cilave mbahet dhe përdoret për qëllime fetare, bamirësie, kujdesit social dhe për aktivitetet e institucionit arsimor për personelin fetar.</p> <p>Testet e kryera lidhur me tatimin në pronën e paluajtshme, në një rast rezulton se prona e paluajtshme e cila ishte institucion fetar ishte vendosur tatim në pronë. Vlera totale e obligimeve në fund të vitit 2022 për këtë pronë ishte 6,160€.</p> <p>Sipas zyrtarëve të Komunës, faturimi i objekteve fetare lidhur me tatimin në pronë ishte si rrjedhojë e pakujdesisë.</p>
<b>Ndikimi</b>	Vendosja e tatimit në pronën e paluajtshme e cila mbahet dhe përdoret për qëllime fetare ndikon në rritjen e llogarive të arkëtueshmeve pa bazë ligjore.
<b>Rekomandimi A12</b>	Kryetari duhet të siguroj forcimin e kontrolleve të brendshme gjatë faturimit të tatimit në pronë dhe në rastet kur tatimi në pronë i ngarkohet pronave të cilat janë të liruara me ligj të bëjë shlyerjen e obligimeve të tyre.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>16,334,504</b>	<b>18,750,711</b>	<b>18,020,858</b>	<b>16,922,197</b>	<b>16,676,230</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	14,521,548	15,714,890	15,517,044	14,568,168	14,891,088
Financimi përmes huamarrjes	0	107,682	107,682	93,813	136,680
Të bartura nga viti i kaluar	0	541,337	494,061	623,022	456,636
Të hyrat vetanake	1,812,956	2,054,989	1,750,633	1,418,764	1,109,380
Donacionet vendore	0	6,197	4,540	2,143	3,446
Donacionet e jashtme	0	325,616	146,898	216,286	79,000

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,416,207€ kjo rritje është rezultat i rishikimit të buxhetit, të hyrave të bartura nga viti paraprak, rritjes së garantit qeveritar, donacioneve vendore të jashtme dhe financimit nga huamarrja.

Në vitin 2022 Komuna ka shpenzuar 96% të buxhetit final, me realizim ngjajshëm me vitin e kaluar.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>16,334,504</b>	<b>18,750,711</b>	<b>18,020,858</b>	<b>16,922,197</b>	<b>16,676,230</b>
Pagat dhe mëditjet	8,571,766	9,368,697	9,303,713	8,868,913	8,519,757
Mallrat dhe shërbimet	2,096,113	2,537,946	2,470,247	2,160,895	1,633,281
Komunalitë	358,449	442,271	382,760	331,882	279,816
Subvencionet dhe transferet	425,000	678,129	676,958	608,298	457,828
Investimet Kapitale	4,433,187	5,723,668	5,187,180	4,952,209	5,785,548
Rezervat	449,989	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final me buxhetin fillestar të kategoria paga dhe mëditje ishte rritur për 796,931€ si rezultat i pagesave shtesë për paga dhe mëditje lidhur me menaxhimin e Covid 19 për sektorin e shëndetësisë sipas vendimit nr.09/56 te datës 26.01.2022;
- Buxheti final në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ishte rritur për 441,833€, apo 97% e buxhetit ishte shpenzuar ndërsa komunalit me buxhet final ishin rritur për 83,822€ në krahasim me buxhetin fillestar;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur 253,129€, përderisa realizimi ishte në masën 99% e buxhetit final;
- Buxheti final në kategorinë e investimeve kapitale në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,290,481€. Kjo rritje është rezultat i ri-shpërndarjes së rezervës, të hyrave të bartura nga viti i kaluar, donacioneve dhe burimeve tjera të financimit. Derisa dinamika e realizimit nuk është në harmoni me planifikimet sepse 3,175,418 apo 61% e shpenzimeve nga kjo kategori janë realizuar në tremujorin e fund vitit. Gjithashtu, vlen të theksohet se nga 94 projekteve të parapara 14 ishin jo të planifikuara.

Si rezultat i situatës pandemike me COVID-19, Komuna e Suharekës kishte shpenzuar 107,682€, prej të cilave janë paguar për paga dhe mëditje.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Në krahasim me vitin paraprak, të hyrat e realizuar në vitin 2022 ishin më pak për 29,321€. Përveç të hyrave tatimore dhe jo tatimore komuna kishte inkasuar edhe të hyra indirekte të cilat mbledhen nga niveli qendror (gjobat në trafik, të gjykatave si dhe nga agjencia e pyjeve) në vlerë prej 403,471€.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>1,812,956</b>	<b>1,812,956</b>	<b>1,834,297</b>	<b>1,863,618</b>	<b>1,503,448</b>
Të hyrat tatimore	1,158,261	1,158,261	884,224	968,556	681,365
Të hyrat jo tatimore	654,695	654,695	950,073	895,063	822,082

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2021 të Komunës së Suharekës ka rezultuar me 11 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna. Përveç kësaj, raporti i auditimit ishte shqyrtuar në kuvendin komunal në mbledhjen e mbajtur me datën 21.07.2022 pika 5 e rendit të ditës.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, gjashtë (6) rekomandime ishin zbatuar, përderisa tre (3) nuk ishin zbatuar, dhe dy (2) pjesërisht të zbatuara. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni më poshtë Tabelën e rekomandimeve:

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës mbajnë evidenca të sakta për detyrimet kontingjente në mënyrë që prezantimi i tyre në pasqyra financiare të jetë i saktë.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
2.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë që, janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet/kategoritë adekuata të buxhetit (apo të ri destinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe saktë sipas kodeve ekonomike adekuata.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar



3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që, hartimi i projekteve ekzekutive të realizohet në pajtim me kërkesat ligjore, gjegjësisht hartimin e tyre para inicimit të procedurave të prokurimit.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatim
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që, Komisioni për vlerësim të aplikacioneve dhe përzgjedhje të përfituesve të subvencioneve të zbatojë të gjitha kriteret e parapara në thirrjen publike dhe në asnjë rast mos të tejkalohet pa dëshmitë për kryerjen e obligimeve tatimore dhe pensionale ndaj Administratës Tatimore.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatim
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që, obligimet të planifikohen/ buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i Komunës me kosto shtesë.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatim
6.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që, para investimeve në teknologjinë e informacionit të marrë pëlqimin nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, si dhe në rastet e kontratës aktive të Agjencisë Qendrore të Prokurimit për shërbime për nivelin lokal ta zbatoj atë.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
7.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që, inicimi i aktiviteteteve të prokurimit bëhet në kohë dhe përdorim të duhur të procedurave të prokurimit.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
8.	Të hyrat	Kryetari të sigurojë bashkëpunim dhe komunikim më të mirë ndërmjet Departamentit të Tatimit në Pronë Komunal dhe Ministrisë së Financave, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në të dhënat për tatimin e vlerësuar, apo ndonjë gabim tjetër eventual.	Janë ndërmarrë veprime, por ende nuk është arritur zbatim i plotë i këtij rekomandimi.	Pjesërisht i zbatuar
9.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se, të gjitha pasuritë e Komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat e pasurisë kapitale dhe jo kapitale duke pasur parasysh edhe përllogaritjen e zhvlerësimit.	Janë ndërmarrë veprime të pjesërishtme për zbatimin e këtij rekomandimi.	Pjesërisht i zbatuar
10.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme në menaxhimin e të arkëtueshmeve dhe të zbatojë mekanizmat ligjor të mbledhjes së tyre.	Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	I zbatuar
11.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë që, mos të pranohen faturat pa u siguruar paraprakisht raportet e pranimi të mallit/ shërbimit, si dhe të merren veprimet e duhura për faturat e pranuar pa raport pranimi përfshirë mospagesën e tyre.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm




Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Florim Maliqi, Udhëheqës i ekipit



Senver Morina, Anëtar i ekipit




Ganimete Dalloshi, Anëtare e ekipit



Arbresha Grainca, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi



### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve

12.06.2023

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPSTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
Nësa orig. për Jedinica No. Unit	Numri i Braj Number	Shtesa Prilag. Appendix	Vlera Vendoset Value
01	016	37338	7

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Suharekës për vitin 2022, "Raporti i auditimit të pasqyrave financiare vjetore të Komunës së Suharekës për vitin 2022"
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Bali MUHARREMAJ

Kryetar i Komunës së Suharekës

Suharekë

Datë: 12/06/2023



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

## Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.